



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.640/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e Zoran Mojsilovic, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Veriut, me seli në Mitrovicën e Veriut, nga radhët e subjektit politik Srpska Lista, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si i pabazuar apeli i parashtuar nga Zoran Mojsilovic, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Veriut, me seli në Mitrovicën e Veriut, nga radhët e subjektit politik Srpska Lista, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017,

## A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it me datën 09.11.2017, ka pranuar një apel nga Zoran Mojsilovic, kandidat për Këshilltar të Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Veriut, me seli në Mitrovicën e Veriut, nga radhët e subjektit politik Srpska Lista, me të cilën thekson se të dhënat e marra nga Komisioni Komunal Zgjedhor, e të cilat janë në përputhje me të dhënat e anëtarëve nga këshillat e vendotimeve, kandidati Vaso Jelic, ka fituar një numër më të madh të votave nga numri i cili është shpallur në rezultatet përfundimtare. Më tej parashtuesi i ankesës kërkon që të rinumërohen votat e kandidatit për Këshilltar Komunal, Vaso Jelic.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është e pa bazuar**

Paneli i PZAP-it, vlerëson se parashtuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesë, nuk ka ofruar asnjë dëshmi të qartë për të vërtetuar pretendimet në ankesë, të paraparë me dispozitën e nenit 117 par. 3 të LZP-së ku është përcaktuar: “*se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”. Paneli gjatë vendosjes së ankesës gjeti se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuara në fakte andaj si të tillë ankesën e refuzoj. Kjo për faktin se pala ankuese nuk ka ofruar asnjë provë

dhe nuk e ka cekur asnjë vendvotim se ku i mungojnë votat, për të vërtetuar pretendimet ankimore.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në kuptim të dispozitave të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, Paneli i PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZL. Anr.640/2017 më datën 10.11.2017.



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.